ResearchGate

See discussions, stats, and author profiles for this publication at: https://www.researchgate.net/publication/373833097

PËRKTHIMI I TERMINOLOGJISË PROFESIONALE NË TEKSTET SHKOLLORE NË SHKOLLËN SHQIPE

Article · September 2021

CITATIONS
0

READS
2

1 author:

Hana Darlishta
State University of Tetova
11 PUBLICATIONS **1** CITATION

SEE PROFILE

All content following this page was uploaded by Hana Darlishta on 11 September 2023.

The user has requested enhancement of the downloaded file.

HANA DARDHISHTA
Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shkup

PËRKTHIMI I TERMINOLOGJISË PROFESIONALE NË TEKSTET SHKOLLORE NË SHKOLLËN SHQIPE

Shkurtore

Duke u bazuar në të dhënat dhe hulumtimet në fushën e përkthimit në përgjithësi, në materialet në dispozicion, kryesisht në gjuhën shqipe dhe maqedonase, por edhe në gjuhë të tjera, në këtë punim do të trajtoj rëndësinë dhe problematikat e përkthimit, me theks të veçantë tek përkthimi i terminologjisë profesionale në tekstet shkollore. Ky punim, megjithatë nuk është shterues lidhur me trajtimin rreth problematikave të kësaj teme apo të përkthimit në përgjithësi, por, shpresoj që kjo qasje të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të interesuar të angazhohen në procesin e përkthimit të teksteve shkollore.

Ky proces (përkthimi) është i një rëndësie tejet të madhe që ka të bëjë me pasoja të drejtëpërdrejta. Ai duhet parë jo vetëm në aspektin gjuhësor, por edhe në aspektin kulturor, social e të tjera, pasi luan rol shumë të madh në edukimin, arsimimin dhe nxënien e njohurive të lëmive të ndryshme nga ana e nxënësve si në shkollat fillore ashtu edhe të shkollave të mesme, duke mos lënë anash edhe studentët (duke pasur parasysh që një numër i madh i tyre shfrytëzojnë literaturë të përkthyer të profesioneve të ndryshme). Për të pasur një përkthim cilësor me theks të veçantë të terminologjisë profesionale, duhet të nxirren në pah si ngjashmëritë

Scanned with CamScanner

ashtu edhe ndryshimet ndërmjet tekstit burimor dhe gjuhës së synuar, kuptohet duke iu referuar edhe fjalorëve të ndryshëm. Që të përkthehet një material në më shumë gjuhë, çdo herë duhet të fillohet nga gjuha burimore dhe asesi të bëhet përkthimi nga një përkthim tjetër (nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase, dhe pastaj nga gjuha maqedonase në gjuhë të tjera).

Ky punim, apo kjo temë është trajtuar me dëshirën jo për të kritikuar, por për të trajtuar si çështje dhe njëkohësisht për të siguruar përkthim cilësor me një përgjegjësi më të madhe në këtë fushë.

Fjalë kyçe: *përkthim, gjuhë, tekste shkollore, terminologji profesionale, fjalor.*

Gjuha jo vetëm që nuk shkruhet gjithnjë mirë e më mirë, por ka kaluar në diçka dytësore, sikur ka harresë për t'u marrë me të.

Shkolla, që njëherit konsiderohet edhe si vatër kryesore e edukimit, arsimimit, formimit gjuhësor (me theks të veçantë edhe gjuha e teksteve shkollore, që përveç se është e një rëndësie të posaçme për nxënien e dijes, gjithashtu i rëndësishëm është edhe roli i tyre në zotërimin e gjuhës standarde shqipe dhe drejtshkrimi i saj) të nxënësve, njëkohësisht detyrat e saj janë të shumta. Duke pasur parasysh mënyrat apo prurjet e reja në arsim, e bashkë me këto edhe tekste të reja shkollore, si rrjedhojë po ballafaqohemi edhe me problematika të gjuhës së teksteve shkollore si rezultat të cilësisë së përkthimit. Kjo problematikë kërkon të trajtohet më hollësisht në ngritjen e nivelit cilësor të tyre. Përveç teksteve shkollore si lëndë e gjuhës amtare, nxënësit kanë edhe shumë tekste shkollore të lëndëve të tjera të nevojshme si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme, të cilat tekste janë paraparë për nxënien e sa më shumë njohurive nga lëmitë ndryshme si dhe në formimin e tyre

Scanned with CamScanner

intelektual. Pra, gjuha e teksteve shkollore ndikon shumë në gjuhën e folur të nxënësve, prandaj edhe përkthimi duhet të jetë i një cilësie të qëndrueshme.

Sa i përket kësaj teme mund të themi që perkthimi konsiderohet si temë komplekse. Është logjike të thuhet që përveç aftësive në përkthim që mund t'i posedojnë përkthyesit, ata kanë nevojë edhe për një nivel të caktuar njohurish apo përvojë rreth temës apo çështjes që mund të jetë si objekt i tekstit shkollor që ata përkthejnë. Në natyrën e çdo përkthyesi fjala është shumë e rëndësishme në përkthim dhe të detyron të gjesh nuancën e caktuar. Fjala duhet të jetë e saktë dhe jo e përafërt, për të shprehur një mendim të caktuar. Për këtë qëllim duhet shfrytëzuar fjalorët terminologjik ekzistues. Në përgjithësi, terminologjia duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë sa më të përpiktë si për termat e mekanikës, të informatikës, të mjekësisë, të termave juridikë, të botanikës etj. Pra, nuk mund të bëhet një përkthim cilësor, në cilëndo gjuhë, pa një terminologji të standardizuar të secilës fushë veçmas. E standardizimi i terminologjisë është punë që lyp përkushtim dhe kohë për hartimin e fjalorëve të ndryshëm terminologjikë cilësor për secilën fushë. Çdo terminologji më së miri kuptohet dhe përdoret nga njerëzit e atij profesioni, duke pasur parasysh që çdo profesion ka terminologjinë e vet. Terminologji kjo e cila mund të jetë edhe e panjohur për të tjerët që i përkasin profesioneve të ndryshme. Megjithëse nuk është e domosdoshme që një përkthyes të jetë ekspert i një fushe, por që është e nevojshme që të ketë njohuri të mira mbi atë lëmi. Posedimi i një lloj mjeshtrie apo aftësie e rishprehjes së materialit origjinal është e domosdoshme për çdo përkthyes, do t'i citoj fjalët e Xhevat Lloshit[93] "Përkthyesi është ambasadori nga një

[93]Lloshi, Xhevat, *Shkrime rreth përkthimit,* Shkup, 2020, f. 154.

Scanned with CamScanner

gjuhë në një tjetër, nga një kulturë në një tjetër; është përcjellësi i kumtit, që nuk ia shton fajet kumtit, por përkundrazi, përpiqet me gjithë dijet dhe aftësitë e tij të përcjellë jo vetëm besnikërisht një përmbajtje, por edhe ta përcjellë atë me gjithë informacionin, me gjithë shijen dhe me vlerat estetike." Mjeshtëria apo aftësia përmban saktësinë, vërtetësinë, kuptimin etj.

Para së gjithash si kriter parësor për një përkthyes është njohja e të dy gjuhëve (gjuha burimore dhe gjuha në të cilën duhet të përkthehet materiali), dhe kjo padyshim që kërkon një pirje. Gjithashtu duhet që përkthyesi në raste të termeve të vështira apo frazave të mund të gjejë ekuivalencë të përshtatshme. Qëllimi kryesor i këtij punimi është që:

- Të nënvizojë nevojën e madhe për përkthyes mirë të trajnuar dhe ekspertë e njohës të fushave të ndryshme.
- Të tregojë arsyet që përkthimi kërkon njohuri të posaçme meqë konsiderohet si proces i specializuar;
- Të japë rekomandime për menaxhim sa më të mirë të procesit të përkthimit tek përkthyesit e rinj.

Duke dashur që përmbajtja e teksteve shkollore të jetë sa më cilësore dhe në hap me vendet e zhvilluara evropiane, Ministria e Arsimit dhe Shkencës u përpoq dhe mundësoi që në shkollat fillore dhe të mesme, për lëndët mësimore të mund të përdoren tekste shkollore përkatëse të adaptuara nga jashtë (Cambridge International Examinations) dhe të përkthyera në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në vendin tonë. Qëllimi çdoherë ka qenë dhe është për të mirën e nxënësve apo të gjeneratave të reja, por nga ana tjetër si nxënësit, arsimtarët, prindërit, institucionet e të tjerë u ballafaquan me problematika të përkthimit (që realisht nuk është se për herë të parë po përballeshin me këtë problematikë). Pavarësisht nga ky

Scanned with CamScanner

punim, i hartuar mbi përkthimin e teksteve shkollore, duke përfshirë dhe terminologjinë profesionale, duhet theksuar se vlera dhe rëndësia e trajnimit të një përkthyesi është po aq e rëndësishme sa edhe njohja e terminologjisë së asaj fushe, p. sh.: një tekst shkollor nga lënda e Kimisë[94] nuk mund të përkthehet vetëm nga një gjuhëtar, i cili nuk ka njohuri nga fusha përkatëse. Përkthimi i tillë do të ishte shumë i dobët dhe i varfër, por gjithashtu edhe jomjaftueshëm i qartë, duke pasur parasysh p.sh.: llojet e ndryshme të "epruvetave" që përdorën gjatë shembujve me reaksionet kimike. Emërtimin e saktë të këtyre "epruvetave" që kanë funksione të ndryshme e që kanë edhe emërtime të posaçme, mund t'i dijë vetëm një njohës i mirë i asaj fushe dhe jo domosdoshmërisht mund t'i dijë çdo përkthyes. Të tillë shembuj ka mjaft dhe gjatë punës përkthyesit i duhet të përballet me sfidat që ngrihen nga probleme jo të hasura më parë, të cilat shfaqen në mënyrë të vazhdueshme dhe në forma nga më të ndryshmet. Problemet që kërkojnë zgjidhje përveç se janë gjuhësore, ato janë edhe social–kulturore, ligjore, stilistikore, etj. Pra, me një fjalë terminologjia është sfida më e madhe e përkthyesve.

Arsyet që tregojnë qartë se përkthimi kërkon njohuri të posaçme janë vetë lëshimet gjatë përkthimeve të teksteve shkollore[95], sido–mos ato profesionale, p.sh.: në tekstin shkollor Arsimi muzikor[96] për klasën e VI–të (Димовска, Ангеловска, Стефановска, 2011: 10) kemi fjalinë: «Prej shkallës së VI të shkallës C–Dur prej tonit a krijohet shkalla e tonit a–mol» që arsimtarët e kësaj lënde nuk e

[94]Tekst shkollor që nuk është tani më në përdorim.
[95]Një pjesë e mirë e shembujve janë marrë prej teksteve shkollore që tani më nuk janë në përdorim, por që deri dje ishin dhe një pjesë tjetër ende janë në përdorim.
[96]Tekste shkollore qe në fakt kanë qenë për arsim fillor tetëvjeçar dhe që janë përshtatur dhe përdorur për arsim fillor nënëtëvjeçar (p. sh. libri për klasë të 6-të tetëvjeçare është përdorë për klasën e 7-të nëntëvjeçare e kështu me radhë).

Scanned with CamScanner

pranojnë si të saktë këtë lloj përkthimi, dhe sipas specialistëve të fushës duhet të jetë «Prej gradës së VI të shkallës C–dur prej tingullit a krijohet shkalla A–mol». Gjithashtu në po të njëjtën lëndë por te tekstet shkollore për klasën e VII (Ангеловска, Стефановска, 2008: 16) dhe VIII (Димовска, Ангеловска, Стефановска, 2010: 67) kemi fjalitë: «Emërtoni tonat me emër alfabetik» e që duhet të jetë «Emërtoni tingujt me alfabet muzikor», pastaj fjalia «Tek lloji natyror, gjysmë gradat gjenden midis shputës së 2–3 dhe 5–6» e që duhet të jetë «Tek lloji natyror gjysëm tonet gjenden midis gradës 2–3 dhe 5–6». Ndërsa titulli i një mësimi është përkthyer «Metri i përbërë i 5/8» e që duhet të jetë «Takti i përbërë i 5/8». Në të tilla raste do të thoja që mbase përkthyesit kanë qenë të ndikuar nga maqedonishtja por edhe nga mosnjohja e saktë e kësaj lëmie.

Gjithashtu, edhe në lëndën e Matematikës[97] ka pasur dhe ende ka lëshime gjatë përkthimit, për të cilat gabime e lëshime kanë reaguar edhe arsimtarët[98] e lëndëve përkatëse por edhe prindërit. Brenda tekstit shkollor mund të hasen edhe fjalë të papërkthyera, pra që janë në gjuhën maqedonase, p.sh.: në vend të fjalës mollëkuqe në tekstin shkollor të matematikës për ciklin e ulët qëndron fjala bumbar, p.sh: Ngjyrosi bumbarët sipas vendeve të tyre (2015: 19) e që në botimet e vitit 2019 është ndryshuar me fjalën brumbull, p.sh.: Ngjyros brumbujt sipas vendeve të tyre (2015: 17) që i bie sërish të kemi paqartësi, shkaku se mollëkuqja është paraqitur në fotografinë e dhënë si shembull. Përkthyesi patjetër që duhet të

[97]Matematika 1 për klasën e parë, pjesa e parë, Shkup, 2015.

[98]Realizimi i një ankete e bërë nga vetë autori me disa arsimtarë të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme, kryesisht nga qyteti i Shkupit, tregon që ka mjaft vërejtje për përkthimet e teksteve shkollore (anketë anonime e realizuar gjatë muajve shtator-tetor, të vitit 2020).

Scanned with CamScanner

konsultohet me fjalorët terminologjikë gjatë përkthimit. Sipas fjalorit terminologjik, mollëkuqja, që njihet me emërtimin latin si *Coccinella septempunctata*[99] dhe që i takon familjes *Coccinellidae*, është insekt i ndryshëm nga brumbulli, që në gjuhën latine ka emërtimin *Bombus terrestris*[100], e që i takon familjes *Apidae*. Pra, është e qartë se kemi të bëjmë me dy lloje të ndryshme insektesh, edhe Fjalori i shqipes së sotme këto dy emërtime i spjegon si në vijim:

- BRÚMBU/LL, −LLI *m. sh.*−J, −JT; *zool.* 1. Kandërr e zezë a e murrme, me krahë të fortë e me brirthë të gjatë, që rron në plehra, në drurë etj.: Brumbull maji. Brumbulli i miellit. Kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë (fj. u.). 2. Mashkulli i bletës. (FSHS, 1984: 111)
- MOLLËKUQ/E, −JA *f. sh.*−E, −ET *zool.* Kandërr e vogël me dy palë krahë, nga të cilët dy të sipërmit janë të kuq e me pika të zeza. (FSHS, 1984: 732)



Të mos harrojmë edhe gabimet gjatë përkthimit në trajtën e shquar, tek po i njëjti tekst shkollor, si p.sh.: bananja në vend të banania,

[99]Lloshi, Xhevat, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve* shqip-latinisht dhelatinisht-shqip, Shkup, 2010, f. 230.
[100]Po aty, f. 409.

Scanned with CamScanner

apo përkthimet e mënyrës urdhërore si: numëroji, ngjyrosi apo ngjyrose, grupoji, plotësoji, shkruaji, ndihmoje, vizatoji, formuloje etj., në vend të numëro, ngjyros, grupo, plotëso, shkruaj, ndihmo, vizato, formulo etj. Gjithashtu edhe elementet e bashkësive në disa raste janë harruar të përkthehen dhe janë dhënë me shkronja cirilike, si p. sh. а, к, у, б dhe kërkohet që nga këto elementë të bashkësisë B të formohet një fjalë (emër të një druri). Formimi i fjalës ***бука*** në gjuhën maqedonase ka kuptimin e drurit të ahut, ndërsa në gjuhën shqipe nuk e kemi të njëjtin kuptim.



Në raste të tilla reagimi vjen jo vetëm nga mësimdhënësit por edhe nga vetë fëmijët, sepse krijon huti tek nxënësit dhe kanë nevojë për sqarim[101].

[101]Matematika për klasën e gjashtë,që tanimë nuk është në përdorim.

Scanned with CamScanner

Nga pakujdesia por edhe nga mosnjohja e fushës, mund të bëhen gabime edhe në titujt e teksteve shkollore, si p.sh.: titulli i tekstit shkollor ***Возила и механизација***[102] për vitin e IV të shkollave të mesme profesionale, drejtimi i makinerisë në gjuhën shqipe është përkthyer ***Automjetet dhe makineria***. Fjala mekanizëm dhe makineri nuk kanë të njëjtin kuptim. Po te i njëjti tekst shkollor, do të vërejmë edhe lëshimin e radhës: shkurtesa EUE[103] (Elektronska upravuvacka edinica) nuk është përkthyer fare, e që sipas specialistëve (inzhinierët e makinerisë, të cilët janë në përgatitje e sipër të një fjalori të unifikuar për të gjitha trevat shqipfolëse) duhet të jetë NJDE (Njësia me drejtim elektronik), etj. E rëndësishme gjithashtu është që gjatë përkthimit nuk duhet lënë anash kontekstin e fjalisë, me theks të veçantë përshtatja, modulimi, elementët e sintaksës së gjuhës burimore dhe procesit të përkthimit apo kalimit në gjuhën tjetër.

Sa i përket rekomandimeve për menaxhim sa më të mirë të procesit të përkthimit tek përkthyesit e rinj, do të duhet një kujdes i posaçëm gjatë përkthimit të fjalëve të specializuara të ligjeve dhe rregulloreve, të biznesit dhe financave, teknologjisë industriale dhe teknologjisë informatike me qëllim që të ketë sa më shumë rritje të burimeve terminologjike nga ana e përkthyesit. Gjithashtu, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet terminologjisë juridike, bujqësore, farmaceutike e mjekësore, përfshirë këtu kiminë, biokiminë, bioteknologjinë, toksikologjinë etj. Duke pasur parasysh që llojet e ndryshme të emërtimeve të botanikës kanë llojin dhe nën llojin e vet e që kanë dhe emërtimin gjenerik apo latin që e bën përkthyesin të jetë edhe më i kujdesshëm gjatë përkthimit sepse

[102]Davçev, Todor, Jançevski, Janko, *Automjetet dhe makineria,* Shkup, 2011.
[103]Po aty, f. 81.

Scanned with CamScanner

përgjegjësia sa vjen e shtohet në të tilla raste përkthimi. Një pjesë e rekomandimeve dhe sugjerimeve që vijnë si rezultate logjike të analizës së përfshirë në këtë punim janë edhe nga përvoja ime gjatë përkthimit të dokumenteve. Për të dorëzuar një shërbim më të saktë dhe më të besueshëm të përkthimit, përkthyesi duhet të jetë më me përvojë dhe i kualifikuar në fushën e tij, p. sh. përvoja e së drejtës, mjekësisë apo finansave etj.

E rëndësishme është që të interpretohet kuptimi, si dhe fjalët që të kemi një përkthim më të saktë të mundshëm. Gjithashtu, një përkthyes duhet të dijë mirë edhe rregullat e drejtshkrimit e të pikësimit të gjuhës shqipe, e për këtë, si referenca duhet të përdorë edhe fjalorët e gjuhës së sotme shqipe.

Bibliografia:

Fjalor i gjuhës shqipe (v. 1954), Ribotim nga "Botimet Çabej", Tiranë 2005.

Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.

Lafe E., Caka N., Duro A., Rizaj M., punim studimor *Terminologjia profesionale si veprimtari ndërdisiplinore dhe detyrat e Alb-shkencës*, nr. 3-4, Shkup, 2014.

Lyons, John, *Hyrje në gjuhësinë teorike,* Tiranë, 2001.

Lloshi, Xhevat, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip*, Shkup, 2010.

Lloshi, Xhevat, *Shkrime rreth përkthimit*, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2020.

https://www.academia.edu/2108309/More_than_one_language_in_the_brain

Scanned with CamScanner

Tekste shkollore që janë shfrytëzuar për analizë:

Dimçe Srebrenov, Petrush Senesov, Goce Zashov, *Automjetet dhe mekanizmat*, për vitin e III, teknik i makinerisë (lëndë e obliguar dhe zgjedhore), Shkup, 2010.

Dimçe Srebrenov, Petrush Senesov, Goce Zashov, *Automjetet dhe mekanizmat*,për vitin e III, drejtimi i makinerisë (lëndë e obliguar dhe zgjedhore), Shkup, 2011.

Matematika 1 përklasën e parë, pjesa e parë, Shkup, 2015.

Matematika 1 përklasën e parë, pjesa e dytë, Shkup, 2015.

Matematika 1 përklasën e parë, pjesa e tretë, Shkup, 2015.

Matematika 1 përklasën e parë, pjesa e parë, Shkup, 2019.

Sllavjanka Dimova, V. Angellovska, Marina Vasiq–Stefanovska, *Arsimi muzikor*, për klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar, Shkup 2011.

Sllavjanka Dimova, V. Angelovska, Marina Vasiq–Stefanovska, *Arsimi muzikor*, për klasën e VII të arsimit fillor tetëvjeçar, Shkup2010.

Todor Davçev, Janko Jançevski, *Automjetet dhe makineria*, për vitin e IV, drejtimi i makinerisë, drejtimi teknik i makinerisë,Shkup, 2011.

Vera Angellovska, Marina Vasiq–Stefanovska, *Arsimi muzikor*, përklasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, Shkup 2008.

Scanned with CamScanner

View publication stats